



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Press Unit
Unité de la Presse

© Këshilli i Evropës, 2021. Përkthimi jozyrtar i bërë nën Projektin "Forcimi i institucioneve të Kosovës* në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimit degradues". Projekti bashkëfinancohet nga ana e qeverisë Norvegjeze dhe Këshillit të Evropës. Ky përkthim nuk e obligon Gjykatën.

© Council of Europe, 2021. Unofficial translation made under the Project on "Strengthening Kosovo* Institutions in Fight against Torture, Ill-treatment and Degrading Treatment". The project is funded by Norwegian government and the Council of Europe. This translation does not bind the Court.

© Conseil de l'Europe, 2021. Cette traduction non officielle a été faite dans le cadre de Project "Renforcer les institutions du Kosovo* dans la lutte contre la torture, les mauvais traitements et les autres traitements dégradants". Le projet est financé par le gouvernement norvégien et le Conseil de l'Europe. Cette traduction ne lie pas la Cour.

* Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe pa ndonjë paragjykim për statusin e Kosovës

*All references to Kosovo, whether the territory, institutions or population, in this text shall be understood in full compliance with United Nations Security Council Resolution 1244 and without prejudice to the status of Kosovo.

* Toute référence au Kosovo mentionnée dans ce texte, qu'elle concerne le territoire, les institutions ou la population, doit se comprendre en plein conformité avec la Résolution 1244 du Conseil de Sécurité de l'Organisation des Nations Unies et sans préjuger du statut du Kosovo.

Fletë faktesh - Vende të burgjeve sekrete

Mars 2019

Kjo fletë faktesh nuk obligon gjykatën dhe nuk është e plotë

Vende të burgjeve sekrete

Rasti i parë i ashtuquajtur "transferimi" i vendosur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

El Masri k. "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë"

13 dhjetor 2012 (Dhoma e Madhe)

Rasti kishte të bënte me ankesat e një shtetasi gjerman me origjinë libaneze se ai kishte qenë viktimë e një operacioni të fshehtë "transferimi" (ang.: redention) gjatë të cilit u arrestua, u mbajt në izolim, u mor në pyetje dhe u keqtrajtua në një hotel në Shkup për 23 ditë, më pas iu transferua agjentëve të CIA-s (Agjencia Qendrore e Inteligjencës) që e sollën atë në një burg të fshehtë në Afganistan, ku ai u trajtua më tej për më shumë se katër muaj.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi deklaratën e aplikantit të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe vendosi se "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" ishte përgjegjëse për torturat dhe keqtrajtimet e tij si në vetë vendin ashtu edhe pas transferimit të tij tek autoritetet e Shteteve të Bashkuara në kontekstin e një "transferimi" jashtëgjyqësor.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, të cilit aplikanti i ishte nënshtruar ndërsa po mbahej në një hotel në Shkup, për shkak të trajtimit të tij në Aeroportin e Shkupit, i cili përbën torturë, dhe për shkak të transferimit të tij nën kujdestari të autoriteteve të Shteteve të Bashkuara, duke e ekspozuar atë ndaj rrezikut të trajtimit të mëtejshëm në kundërshtim me Nenin 3. Gjykata gjithashtu konstatoi **shkelje të Nenit 3** për shkak të dështimit të "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë" për të kryer një hetim efektiv mbi pretendimet e aplikantit për keqtrajtim.

Gjykata më tej vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri) e Konventës, për shkak të ndalimit të aplikantit në hotelin në Shkup për 23 ditë dhe të robërisë së tij pasuese në Afganistan, si dhe për shkak të dështimit për të kryer një hetim efektiv të pretendimeve të tij të ndalimit arbitrar.

Në fund, Gjykata konstatoi **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private

dhe familjare) dhe **shkelje të nenit 13** (e drejta për mjete juridike efektive) të Konventës.

Aktgjykimet e fundit të Gjykatës

Al Nashiri k. Polonisë dhe Husayn (Abu Zubaydah) k. Polonisë

24 korrik 2014

Këto dy raste kishin të bënin me pretendime për torturë, keqtrajtim dhe ndalim të fshehtë të dy burrave të dyshuar për akte terroriste. Të dy aplikantët pohuan se ishin mbajtur në një "vend të zi" të CIA-s në Poloni. Ata pohuan në veçanti se Polonia me vetëdije dhe qëllimisht i kishte mundësuar CIA-s që t'i mbante ata në burg të fshehtë në objektin Stare Kiejkuty, përkatësisht për gjashtë dhe nëntë muaj, pa ndonjë bazë ligjore ose shqyrtim dhe pa ndonjë kontakt me familjet e tyre. Ata u ankuan se Polonia me vetëdije dhe qëllimisht kishte mundësuar transferimin e tyre nga territori polak, pavarësisht nga rreziku real i keqtrajtimit të mëtejshëm dhe paraburgimit pa komunikim, duke iu mundësuar atyre të transferoheshin në një juridiksion ku do t'u mohohej një gjykim i drejtë. Më në fund, ata u ankuan se Polonia nuk kishte arritur të kryejë një hetim efektiv për rrethanat që kishin të bënin me keqtrajtimin, ndalimin dhe transferimin e tyre nga territori polak.

Duke pasur parasysh provat para saj, Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e aplikantëve se ishin arrestuar në Poloni ishin mjaft bindëse. Gjykata konstatoi se Polonia kishte bashkëpunuar në përgatitjen dhe ekzekutimin e transferimit të CIA-s, operacioneve për burim fshehtë dhe marrje në pyetje në territorin e saj dhe duhej të kishte ditur që duke i mundësuar CIA-s të arrestonte aplikantët në territorin e saj, po i ekspozonte ata ndaj rrezikut serioz për trajtim në kundërshtim me Konventën.

Në të dy rastet, Gjykata vendosi që Polonia nuk kishte **arritur të respektonte** detyrimin e saj sipas **Nenit 38** (detyrimi për të siguruar të gjitha lehtësitë e nevojshme për kryerjen efektive të një hetimi) të Konventës. Më tej, në të dy rastet, u konstatua se kishte pasur **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) të Konventës, në të dy aspektet e saj materiale dhe procedurale, **shkelje të Nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri), **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), **shkelje të Nenit 13** (e drejta për mjet efektiv juridik) dhe **shkelje të Nenit 6 1** (e drejta për gjykim të drejtë) të Konventës. Sa i përket aplikantit të parë, Gjykata në fund vendosi që kishte pasur **shkelje të neneve 2** (e drejta për jetë) dhe **3 të marra së bashku me Nenin 1** (heqja e dënimit me vdekje) të **Protokollit Nr. 6** në Konventë.

Nasr dhe Ghali k. Italisë

23 shkurt 2016

Ky rast kishte të bënte me "transferimin e jashtëzakonshëm" - rrëmbimin nga agjentët e CIA-s, me bashkëpunimin e shtetasve italianë - të hoxhës egjiptian Abu Omar, dhe transferimin e tij në Egjipt, pasuar nga ndalimi i tij sekret atje për disa muaj. Aplikanti u ankua në veçanti për rrëmbimin e tij me pjesëmarrjen e autoriteteve italiane, keqtrajtimin e përjetuar gjatë transferimit dhe ndalimit të tij, mosndëshkimin e gëzuar nga personat përgjegjës për shkak të sekretit shtetëror dhe dështimin për të zbatuar dënimet e shqiptuara ndaj shtetasve amerikanë të dënuar për shkak të refuzimit të autoriteteve italiane për të kërkuar ekstradimin e tyre. Së fundmi, ai dhe gruaja e tij - aplikanti i dytë - u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për respektim të jetës private dhe familjare, duke qenë se rrëmbimi dhe ndalimi i aplikantit të parë kishin rezultuar në ndarjen e tyre me forcë për më shumë se pesë vjet.

Gjykata vendosi, në lidhje me *aplikantin e parë*, se kishte pasur shkelje të Nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës), **shkelje të Nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri), **shkelje të Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), dhe **shkelje të Nenit 13** (e drejta për mjet efektiv juridik) **të lexuar së bashku me nenet 3, 5 dhe 8** të Konventës. Në lidhje me *kërkuesi i dytë*, qëndroi se kishte pasur një **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues), **të Nenit 8** (e drejta për respekt për jetën private dhe familjare) dhe **të Nenit 13** (e drejta për një zgjidhje efektive) **lexuar bashkë me nenet 3 dhe 8**. Në veçanti, duke marrë parasysh të gjitha provat në rastin, Gjykata konstatoi se vërtetoi që autoritetet italiane ishin të vetëdijshëm se aplikanti i parë kishte qenë viktimë e një operacioni të jashtëzakonshëm transferimi që kishte filluar me rrëmbimin e tij në Itali dhe kishte vazhduar transferimi i tij jashtë vendit. Në rastin në fjalë, Gjykata vendosi që parimi legjitim i "Sekretit shtetëror" ishte zbatuar qartë nga ekzekutivi italian në mënyrë që të sigurohej që personat përgjegjës nuk do të përgjigjeshin për veprimet e tyre. Hetimi dhe gjykimi nuk kishin çuar në dënimin e përgjegjësve, të cilëve në fund të fundit u ishte dhënë pandëshkueshmëri.

Abu Zubavdah k. Lituanië

31 maj 2018

Ky rast kishte të bënte me pretendimet e aplikantit se Lituania kishte lejuar Agjencinë Qendrore të Inteligjencës të Shteteve të Bashkuara (CIA) ta transportonte atë në territorin e saj nën programin e fshehtë të transferimit të jashtëzakonshëm dhe e kishte lejuar atë që t'i nënshtrohej keqtrajtimit dhe ndalimit arbitrar në një qendër mbajtjeje të CIA-s të quajtur "vend i zi".

Ai gjithashtu u ankua se Lituania kishte dështuar të kryente një hetim efektiv për pretendimet e tij.

Në këtë rast, Gjykata nuk kishte qasje te aplikanti pasi ai ishte ende duke u mbajtur nga autoritetet amerikane në kushte shumë kufizuese, kështu që iu desh të vërtetonte faktet nga burime të ndryshme të tjera. Në veçanti, ajo mori informacione kyçe nga një raport i Komitetit të Senatit të SHBA-ve mbi torturat e CIA-s i cili u lëshua në dhjetor 2014. Ajo gjithashtu dëgjoi dëshminë e dëshmitarit ekspert. Gjykata vendosi që në rastin e aplikantit kishte pasur **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i torturës) i Konventës, për shkak të dështimit të Qeverisë për të hetuar në mënyrë efektive pretendimet e tij dhe për shkak të bashkëpunimit të saj në veprimet e CIA-s që kishin çuar në keqtrajtim, si dhe **shkelje të Nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri), **Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private), **dhe Nenit 13** (e drejta për një mjet juridik efektiv) **së bashku me Nenin 3**. Gjykata vuri në dukje në veçanti se Lituania kishte organizuar një burg të fshehtë të CIA-s midis shkurtit 2005 dhe marsit 2006, që aplikanti ishte ndaluar atje dhe se autoritetet vendase e kishin ditur që CIA do ta nënshtrohte atë ndaj trajtimit në kundërshtim me Konventën. Lituania gjithashtu e kishte lejuar atë që të zhvendosej në një vend tjetër ndalimi të CIA-s në Afganistan, duke e ekspozuar atë ndaj një keqtrajtimi të mëtejshëm. Gjykata, pra, konstatoi që aplikanti kishte qenë nën juridiksionin e Lituanisë dhe se vendi kishte qenë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të tij sipas Konventës. Gjykata më tej rekomandoi që Lituania të kryejë një hetim të plotë të rastit të aplikantit sa më shpejt të jetë e mundur dhe, nëse është e nevojshme, të ndëshkojë çdo zyrtar përgjegjës. Në fund u shpreh se vendi gjithashtu duhej të bënte përfaqësime të mëtejshme në Shtetet e Bashkuara për të hequr ose kufizuar efektet e shkeljeve të të drejtave të tij.

Al Nashiri k. Rumanisë

31 maj 2018

Aplikanti në këtë rast po përballej me akuza kapitale në SHBA për rolin e tij të pretenduar në sulmet terroriste. Rasti kishte të bënte me pretendimet e tij se Rumania i kishte mundësuar Agjencisë Qendrore të Inteligjencës të Shteteve të Bashkuara (CIA) ta transportonte atë nën programin e transferimit të jashtëzakonshëm sekret në territorin e saj dhe i kishte mundësuar atij t'i nënshtrohej keqtrajtitimit dhe ndalimit arbitrar në një "vend të zi" të ndalimit të CIA-s. Ai gjithashtu u ankua se Rumania kishte dështuar të kryente një hetim efektiv për pretendimet e tij.

Në këtë rast, Gjykata nuk kishte qasje te aplikanti pasi ai ishte ende duke u mbajtur nga autoritetet amerikane në kushte shumë kufizuese, kështu që iu desh të vërtetonte faktet nga burime të ndryshme të tjera. Në veçanti, ajo mori informacione kyçe nga një raport i Senatit të SHBA-ve mbi torturat e CIA-s i cili u lëshua në dhjetor 2014. Ajo gjithashtu dëgjoi dëshminë e dëshmitarit ekspert. Gjykata vendosi që në rastin e aplikantit kishte pasur **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i torturës) i Konventës, për shkak të dështimit të Qeverisë rumune për të hetuar në mënyrë efektive pretendimet e aplikantit dhe për shkak të bashkëpunimit të saj në veprimet e CIA-s që kishin çuar në keqtrajtim. Gjykata gjithashtu vendosi që kishte pasur **shkelje të Nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri), **Nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private), **dhe Nenit 13** (e drejta për një mjet juridik efektiv) **së bashku me nenet 3, 5 dhe 8**. Në fund, u konstatua se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 1** (e drejta për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme) të Konventës, **dhe nenet 2** (e drejta për jetë) **dhe 3** të Konventës **marrë së bashku me Nenin 1** (heqja e dënimit me vdekje) **të Protokollit Nr. 6** në Konventë sepse Rumania kishte ndihmuar në transferimin e aplikantit nga territori i saj, përkundër një rreziku real që ai mund të përballej me një mohim flagrant të drejtësisë dhe dënimin me vdekje. Gjykata vuri në dukje në veçanti se Rumania kishte organizuar një burg të fshehtë të CIA-s, që e kishte emër të koduar, Vend ndalimi i zi, midis shtatorit 2003 dhe nëntorit 2005, që aplikanti ishte ndaluar atje për rreth 18 muaj, dhe se autoritetet vendase e kishin ditur që CIA do ta nënshtrohte atë ndaj trajtimit në kundërshtim me Konventën. Rumania gjithashtu e kishte lejuar atë që të zhvendosej në një vend tjetër ndalimi të CIA-s që ndodhej ose në Afganistan (Vend ndalimi i kaftë) ose në Lituaninë (Vend ndalimi vjollce), duke e ekspozuar kështu ndaj një keqtrajtimi të mëtejshëm. Gjykata, pra, konstatoi që aplikanti kishte qenë nën juridiksionin e Rumanisë dhe se vendi kishte qenë përgjegjës për shkelje të të drejtave të tij sipas Konventës.

Gjykata më tej rekomandoi që Rumania të kryejë një hetim të plotë në rastin e aplikantit sa më shpejt të jetë e mundur dhe, nëse është e nevojshme, të ndëshkojë çdo zyrtar përgjegjës. Gjykata më në fund vendosi që vendi duhet të kërkojë gjithashtu sigurime nga Shtetet e Bashkuara se aplikanti nuk do të vuante dënimin me vdekje.

Kërkesa në pritje

al-Hawsawi k. Lituanië (nr. 6383/17)

Kërkesa i është komunikuar qeverisë lituaneze më 30 janar 2019

Ky rast ka të bëjë me pretendimet e aplikantit se Lituania ka lejuar Agjencinë Qendrore të Inteligjencës të Shteteve të Bashkuara (CIA) ta transportonte atë në territorin e saj nën programin e fshehtë të transferimit të jashtëzakonshëm dhe ka lejuar atë që t'i nënshtrohej keqtrajtimit dhe ndalimit arbitrar në një qendër mbajtjeje të CIA-s të quajtur "vend i zi".

Gjykata dha njoftimin për kërkesën tek Qeveria lituaneze dhe u bëri pyetje palëve sipas neneve 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut), 2 (e drejta për jetë), 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues), 5 (e drejta e lirisë dhe sigurisë), 6 (e drejta për një gjykim të drejtë), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) të Konventës dhe sipas Nenit 1 (heqja e dënimit me vdekje) të Protokollit Nr. 6 të Konventës.

Kontakti i medias:

Tel.: +33 (0)3 90 21 42 08